

VENDIM
Nr.190, datë 20.5.2005

PËR SHPËRNDARJEN E LEGJISLATURËS XVI TË KUVENDIT
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 65 dhe 78 të Kushtetutës, si dhe të nenit 7 pika 3 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Shpërndarja e Legjislaturës XVI të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për efekt të zgjedhjeve për Kuvendin e ri, bëhet në datën 20 maj 2005.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi